

**KOALICIONI PËR KOMRA**

**NDRYSHIME  
STATUTI**

**I KOMISIONIT RAJONAL PËR PËRCAKTIMIN E  
FAKTEVE PËR KRIMET E LUFTËS DHE  
SHKELJEVE TË TJERA TË RËNDA TË TË  
DREJTAVE TË NJERIUT NË TERRITORIN E  
JUGOSLLAVISË SË DIKURSHME**

**Në bazë të propozimit të të dërguarit të  
kryetarit/Presidencës së B dhe H për KOMRA**

**28. tetor 2014**

shqip

## **Përmbajtja**

<i>Preambula</i> .....	4
<b><i>PJESA I – DOMETHËNIA E NOCIONEVE NË KËTË STATUT</i></b> .....	5
Neni 1 – Kuptimi i nocioneve në këtë Statut.....	5
<b><i>PJESA II – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</i></b> .....	8
Neni 2 – Definicioni.....	8
Neni 3 – Simbolet.....	8
Neni 4 – Selia dhe Sekretariati Ekzekutiv.....	8
Neni 5 – Statusi juridik.....	8
Neni 6 – Periudha e veprimit.....	9
Neni 7 – Përfaqësimi dhe prezantimi .....	9
Neni 8 – Përdorimi i gjuhëve.....	9
Neni 9 – E drejta për pjesëmarrje në punën e Komisionit.....	10
Neni 10 – Parimet e veprimtarisë së Komisionit.....	10
<b><i>PJESA III – DETYRIMI PËR BASHKËPUNIM ME KOMISIONIN</i></b> .....	11
Neni 11 – Detyrimi i palëve kontraktuese për bashkëpunim me Komisionin .....	11
Neni 12 – Bashkëpunimi i Komisionit me shtetet tjera dhe me organizatat ndërkombëtare.....	12
<b><i>PJESA IV – QËLLIMET DHE DETYRAT E KOMISIONIT</i></b> .....	12
Neni 13 – Qëllimet .....	12
Neni 14 – Detyrat .....	13
<b><i>PJESA V – KOMPETENCAT E KOMISIONIT</i></b> .....	14
Neni 15 – Periudha dhe territori i hulumtimit .....	14
Neni 16 – Shkelja e të drejtave në kompetencat e Komisionit.....	15
<b><i>PJESA VI – AUTORIZIMET E KOMISIONIT</i></b> .....	15
Neni 17 – Marrja e deklaratave.....	15
Neni 18 – Grumbullimi i dokumentacionit dhe i burimeve të tjera.....	17
Neni 19 – Hulumtimet në terren dhe vizitatv.....	18
Neni 20 – Dëgjimet publike të viktimave dhe personave të tjerë.....	18
Neni 21 – Mbajtja e sesioneve tematike .....	19
Neni 22 – Rregulloret e Komisionit.....	19
<b><i>PJESA VII – ZGJEDHJA E ANËTARËVE DHE ANËTAREVE TË KOMISIONIT</i></b> .....	20
Neni 23 – Përbërja e Komisionit.....	20
Neni 24 – Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit.....	20
Neni 25 – Njëjtësia e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit.....	21
Neni 26 – Kandidimi i anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit.....	21

2

Neni 27 – Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit seleksionues .....	22
Neni 28 – Zgjedhja e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim në Komision nga ana e Këshillit zgjedhor .....	23
Neni 29 – Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit nga ana e kryetarit/kryesisë së palëve kontraktuese .....	24
Neni 30 – Mbledhja konstitutive.....	25
Neni 31 – Zgjedhja e kryesuesit/kryesueses dhe miratimi i Rregullores së punës.....	25
Neni 32 – Kuorumi dhe vendimmarrja .....	25
Neni 33 – Pushimi i mandatit të anëtarit/anëtares së Komisionit.....	26
Neni 34 – Largimi i përkohshëm nga detyra e anëtarit/anëtares të Komisionit – Propozim i Koalicionit për KOMRA, e fshirë .....	27
 <b><i>PJESA VIII – TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE/ANËTAREVE DHE PERSONELIT TË KOMISIONIT</i></b> .....	
Neni 34 – Ndërgjegjshmëria, pavarësia dhe paanshmëria .....	28
Neni 35 – Privilegjet dhe imuniteti .....	29
Neni 36 – Mbrojtja e burimeve dhe të dhënave të besueshme .....	29
Neni 37 – Statusi i anëtarëve/anëtareve dhe personelit të Komisionit.....	30
 <b><i>PJESA IX – STRUKTURA E KOMISIONIT</i></b> .....	
Neni 38 – Sekretariati ekzekutiv dhe departamentet tematike .....	30
Neni 39 – Zyrat e Komisionit në palët kontraktuese .....	30
Neni 40 – Arkivi .....	31
 <b><i>PJESA X – FINANCIMI I KOMISIONIT</i></b> .....	
Neni 41 – Financimi .....	32
Neni 42 – Raportimi financiar .....	33
 <b><i>PJESA XI – RAPORTI PËRFUNDIMTAR I KOMISIONIT</i></b> .....	
Neni 43 – Hartimi dhe publikimi i Raportit përfundimtar.....	33
Neni 44 – Përmbajtja e Raportit përfundimtar.....	34
Neni 45 – Gjetjet për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të së drejtës njerëzore .....	35
Neni 46 – Obligimet e parlamenteve dhe qeverive për shqyrtimin e Raportit përfundimtar.....	36
 <b><i>(PJESA XII – TË NDRYSHME – Propozim i Koalicionit për KOMRA, e fshirë</i></b> .....	
Neni 48 – Dispozitat ndëshkimore .....	36
Neni 49 – Roli i Komisionit në procedimin penal) .....	37
 <b><i>PJESA XIII – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE</i></b> .....	
Neni 48 – Përfundimi i punës së Komisionit.....	38
Neni 49 – Hyrja në fuqi e Statutit.....	38
Neni 49 – Përgatitjet për themelimin e Komisionit –nen i ri, të dërguarit për KOMRA. ....	39

# *Preambula*

## *Palët kontraktuese,*

Duke vërejtur se gjykimet para Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë dhe në gjykatat vendore, edhe pse dukshëm i kontribuojnë dënimit të kryerësve të krimit, nuk përbushin, në masë të duhur nevojën e viktimave për drejtësi, dhe as vetvetiu nuk mund të krijojnë kushte të mjaftueshme për arritjen e paqes së qëndrueshme në rajon;

Duke shprehur bashkëndjesi me viktimat e të gjithë popujve në territorin e RSFJ-së së dikurshme, dhe duke kundërshtuar keqpërdorimin e viktimave për qëllime politike dhe garës në viktimizim; Duke vërejtur se iniciativa e ndërmarrë në nivel rajonal dhe e bazuar në dialog të hapur, hulumtim dhe analizën e fakteve, paraqet rrugën më të mirë të të dhënave gjithëpërfshirëse historike për krimet të cilat janë kryer në periudhën e përmendur, si dhe për rolin e elitave nacionale, institucioneve dhe individëve në ngjarjet traumatike;

4

Të vendosura që në masën më të madhe të mundshme të ndihmojnë për vërtetimin e fatit të një numri të madh të individëve të cilët edhe më tutje evidentohen si të pagjetur;

Të vendosura që bashkërisht të kontribuojnë në pranimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut ndaj të gjitha viktimave dhe përtëritjes së mirëbesimit në mes të individëve, popujve dhe shteteve në rajon;

Me qëllim të forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit dhe të kulturës për respektimin e të drejtave të njeriut,

Të vendosur për të respektuar parimet morale të gjykimit të të gjitha krimeve të luftës dhe kryerësit e tyre si dhe të gjitha format e shkeljes së të drejtave të njeriut; - **nen i ri, të dërguarit për KOMRA**

## *Shpallin*

***Themelimin e Komisionit rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme, në periudhën nga viti 1991 deri në vitin 2001.***

# PJESA I – KUPTIMI I NOCIONEVE NË KËTË STATUT

## Neni 1

### *Kuptimi i nocioneve në këtë Statut*

- “Luftëtarë“ në kontekstin e konfliktit të armatosur ndërkombëtar janë:
  - Pjesëtarë të forcave të armatosura të njëres anë në konflikt, si dhe pjesëtarë të milicive dhe njësive vullnetare të cilat hyjnë në përbërje të atyre forcave të armatosura,
  - Pjesëtarët e milicive dhe të njësive të tjera vullnetare, duke nënkuptuar me atë edhe lëvizjet e organizuara të rezistencës, të cilat i përkasin njëres anë të konfliktit dhe të cilat veprojnë jashtë apo brenda territorit të tyre, bile edhe nëse ky territor është i okupuar, me kusht që këto milici apo njësi vullnetare, duke nënkuptuar me atë dhe lëvizjet e organizuara të rezistencës i plotësojnë kushtet si në vijim:
    - a) që në krye të kenë një person përgjegjës për vartësit e tij;
    - b) të kenë një shenjë të caktuar dalluese e cila mund të shihet në distancë;
    - c) që haptazi të mbajnë armë;
    - d) që në kryerjen e operacionit të tyre i përmbahen ligjeve të luftës;
  - Pjesëtarë të forcave të rregullta të armatosura të cilat deklarohen që i takojnë ndonjë qeverie apo pushteti të cilën nuk e ka njohur fuqia ndër pushtetin e së cilit janë;
  - Popullata e territorit të pa okupuar e cila gjatë afrimit të armikut, në mënyrë të vullnetshme merr armët për t'i rezistuar pushtimit armiqësor, dhe e cila nuk ka pasur kohë për tu organizuar si një forcë e rregullt e armatosur, nëse ajo hapur mban armë edhe nëse i respekton ligjet e luftës dhe zakonet-(të ashtq. Levee en masse).

*Luftëtarë* në konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare konsiderohen:

- pjesëtarët e forcave të armatosura të shtetit, dhe
- pjesëtarët e forcave të armatosura disidente dhe të grupeve të tjera të armatosura të organizuara, të cilat, nën komandën përgjegjëse, kryejnë kontrollin mbi një pjesë të caktuar të territorit që ju mundëson të zbatojnë operacione ushtarake të vazhdueshme dhe të harmonizuara, dhe të zbatojnë dispozitat e të drejtës Humanitare ndërkombëtare të përcaktuara me Protokollin Plotësues II shtesë katër Konventat e Gjenevës;

- **“Civil”** janë të gjithë personat që nuk janë luftëtarë;
- **“Anëtari/anëtarja e Komisionit”**, është person i zgjedhur nga ana e kryetarit të palës kontraktuese, sipas procedurës së paraparë në Pjesën VII. të Statutit;
- **“Komisioni”** është Komision Rajonal për vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë së dikurshme (shkurtesa e emrit është: KOMRA);
- **„Vendi i burgimit”** është një hapësirë e mbyllur ose e hapur në të cilin gjenden një apo më shumë persona të cilët janë të privuar nga liria;
- **“Ministri kompetent për të drejtat e njeriut”**, nënkupton ministrin/ministren për të drejtat e njeriut dhe të pakicave në shtetet ku ekziston një pozitë e tillë, ndërsa në shtetet tjera ministri/ministrja e drejtësisë, gjegjësisht ministri/ministrja për komunitetet dhe kthim; - Propozim i Koalicionit për KOMRA, e fshirë
- **„Personi i pagjetur”** është personi i arrestuar, i paraburgosur i rrëmbyer apo në çfarëdo mënyre tjetër i privuar nga liria nga ana e autoriteteve shtetërore apo grupit të armatosur e cila aktivisht kundërvihej, gjegjësisht nga ana e personit apo grupit të personave të cilët veprojnë sipas autorizimit, me mbështetje dhe pëlqim të organeve shtetërore apo të grupit të armatosur, pas së cilës organet apo personi, gjegjësisht grupet, të cilat e kanë privuar nga liria personin, refuzojnë të pranojnë se e kanë privuar nga liria, apo e fshehin fatin e personit të pagjetur ose vendin ku ai gjendet, dhe/ose personi i humbur në konfliktin e armatosur, rrethanat e humbjes së të cilit janë të njohura për organet kompetente shtetërore, apo të cilat janë akoma duke u hulumtuar;
- **„Pjesëtarë të forcave të armatosura”** janë pjesëtarë të forcave të armatosura të rregullta të shtetit, grupeve dhe njësisve të vëna nën komandën që i përgjigjet shtetit;
- **“Lufta ose forma tjetër e konfliktit të armatosur”**, nënkupton përdorimin e forcës së armatosur ndërmjet shteteve ose dhunës së vazhdueshme të armatosur ndërmjet pushtetit dhe grupeve të armatosura të organizuara, gjegjësisht ndërmjet grupeve të armatosura të organizuara brenda një shteti;
- **“Krim lufte”**, nënkupton domethënien e terminit *“krim lufte”* në të drejtën humanitare ndërkombëtare, gjenocidi dhe krime kundër njerëzimit, dhe përfshin por nuk kufizohet në krimet e kryera si në vijim:
  - a. gjenocid;
  - b. persekutim;

- c. vrasje;
- d. robërim;
- e. burgosje kundërligjore;
- f. torturë;
- g. zhdukjet e dhunshme;
- h. dëbim dhe zhvendosje e dhunshme e popullatës;
- i. përdhunimi dhe format e tjera të rënda të abuzimit seksual;
- j. konfiskimi dhe shkatërrimi i pronave në përmasa të mëdha;
- k. marrja e pengjeve;
- l. shkatërrimi i objekteve fetare, kulturore, historike;
- m. përdorimi i civilëve dhe i robërve të luftës si “mburojë e gjallë”;

- “**Trupi parlamentar kompetent për të drejtat e njeriut dhe të pakicave**”, nënkupton, varësisht nga emri në palët e ndryshme kontraktuese, këshillet parlamentare ose komisionet kompetente për të drejtat e njeriut ose marrëdhëniet ndërnacionale; **Propozim i Koalicionit për KOMRA, e fshirë**

- “**Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ)**”, ishte shteti, të cilin e përbënin gjashtë republika socialiste: Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia, Serbia dhe dy krahina autonome; Kosova dhe Vojvodina; dhe e cila *de facto* ka ekzistuar që nga 29 nëntori 1943, deri në shkatërrimin e saj në vitin 1991, duke ndërruar ndërkohë emërtimin disa herë;

- “**Shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut**”, përfshijnë: vrasjet, robërimet, burgosjen kundërligjore, torturimin, zhdukjet e dhunshme, deportimin dhe shpërnguljen e dhunshme të popullsisë, diskriminimin sistematik, si dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut, të parapara me Paktet Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe kontratat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat i kanë obliguar të gjitha palët kontraktuese për të cilat Komisioni vlerëson se sipas karakteristikave dhe pasojave të tyre kanë karakter të “shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut”;

- “**Kryerësi**”, është personi i cili plotfuqishmërisht është gjykuar si kryerës, bashkëkryerës apo bashkëpjesëmarrës në kryerjen e krimit të luftës apo veprave tjera që paraqesin shkelje tjera të të drejtave të njeriut;

- “**Viktimat**” janë personat të cilët, individualisht apo kolektivisht, kanë pësuar dëme, duke përfshirë lëndimet fizike ose psikike, vuajtje shpirtërore, humbje ekonomike ose kufizime të konsiderueshme të të drejtave të tyre themelore përmes veprimeve ose mosveprimeve që paraqesin shkelje të rënda të të drejtave njerëzore të pranuar me të drejtën ndërkombëtare, ose shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Termi

“viktima”, gjithashtu përfshin edhe anëtarët e familjes më të ngushtë ose personat për të cilët viktima ka qenë ushqyes i tyre i drejtpërdrejtë, si dhe personat të cilët kanë pësuar dëme gjatë ndërhyrjes, qëllimi i së cilës ka qenë për t'i ndihmuar viktimës apo të parandalojë shkeljet tjera.

## PJESA II – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 2

#### *Definicioni*

1. Komisioni rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e ish RSFJ-së themelohet me këtë marrëveshje ndërkombëtare. - ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Komisioni rajonal për vërtetimin e fakteve, për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e RSFJ-së së dikurshme, është Organizatë Ndërkombëtare e themeluar me këtë akt ligjor) – Propozim i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
2. Emërtimi i shkurtuar është KOMRA.

### Neni 3

#### *Simbolet*

Komisioni vendos mbi identitetin e vet vizual që përfshin emblemën, logon dhe vulën.

### Neni 4

#### *Selia dhe Sekretariati Ekzekutiv*

1. Selia e Komisionit është në Sarajevë.
2. Mbështetje në punën e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit siguron Sekretariati Ekzekutiv, në selinë e Komisionit.

### Neni 5

#### *Statusi juridik*

1. Komisioni ka subjektivitet Juridik.



2. Komisioni miraton buxhetin, rregulloren e punës dhe rregulloret me të cilat rregullohet organizimi dhe implementimi i detyrave të tij, në pajtim me këtë Statut.
3. Komisioni, me pushtetin kompetent të Bosnjës dhe Hercegovinës, do të lidhë Marrëveshje mbi aranzhmanet me vendin nikoqir.

## Neni 6

### *Periudha e veprimit*

1. Periudha e veprimit të Komisionit është tri vjet.
2. Periudha e veprimit të Komisionit nuk përfshin periudhën e përgatitjeve, e cila fillon nga mbledhja konstituive dhe vazhdon, më së gjati, gjashtë muaj.
3. Nëse është e nevojshme për realizimin e detyrave, Komisioni mund ta zgjasë periudhën e veprimit me kushtin që i ka të siguruara mjetet financiare. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Komisioni mund ta zgjasë periudhën e veprimit më së shumti për gjashtë muaj.) – Propozim i Koalicionit për KOMRA, e fshirë

## Neni 7

### *Përfaqësimi dhe paraqitja*

1. Komisionin e përfaqëson dhe e paraqet kryesuesi/ja i/e Komisionit.
2. Komisioni mund të vendosë që ta përfaqësojë një anëtar ose anëtare tjetër.

## Neni 8

### *Përdorimi i gjuhëve*

1. Në punën e Komisionit, në përdorim të barabartë janë gjuha shqipe, boshnjake, malazeze, kroate, maqedonase, sllovene dhe serbe, alfabeti cirilik dhe latin, si dhe gjuha e shenjave për personat e shurdhër, në pajtim me zonat prej nga vjen ai person.
2. Përdorimin e gjuhës dhe të shkrimeve Komisioni do ta rregullojë më hollësisht me Rregulloren e punës, duke respektuar parimet e efikasitetit dhe nikoqirllëkut.

3. Në komunikim me Komisionin, secili ka të drejtë të shfrytëzojë gjuhën dhe alfabetin e vet.
4. Në dëgjimet publike pjesëmarrësit flasin në gjuhën e tyre.
5. Në zyrat e palëve kontraktuese, në pikëpamje të gjuhës, zbatohen dispozitat e shtetit në të cilin gjendet zyra.

#### **Neni 9**

##### ***E drejta për të kontribuar në punën e Komisionit***

Secili gëzon të drejtën, në përputhje me Statutin, të kontribuojë në punën e Komisionit, nëse Komisioni e vlerëson se një gjë e tillë do të kontribuoj në realizimin e qëllimeve të tij.

#### **Neni 10**

##### ***Parimet e veprimit të Komisionit***

Anëtarët/anëtares si dhe personeli i Komisionit janë të obliguar që në punën e tyre të udhëhiqen me këto vlera dhe parime:

10

- (a) respektimi i dinjitetit njerëzor,
- (b) pavarësia dhe paanshmëria,
- (c) përkushtimi për të vërtetën,
- (d) barazia dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut,
- (e) përgjegjësia, qasja dhe të qenit të hapur,
- (f) hulumtimi me kujdes i fakteve dhe drejtshmëria e procedurës,
- (g) integritet, vendosmëri dhe përmbajtje në standardet më të larta profesionale dhe etike,
- (h) mbrojtja e veçantë e viktimave të keqtrajtimit seksual si dhe personave të cilët ishin të mitur në periudhën të cilën e përfshin mandati i Komisionit,
- (i) ruajtja e konfidencialitetit.

# PJESA III – DETYRIMI I BASHKËPUNIMIT ME KOMISIONIN

## Neni 11

### *Detyrimi i bashkëpunimit të palëve kontraktuese me Komisionin*

1. Palët kontraktuese krijojnë kushte për kryerjen efikase të detyrave të Komisionit në përputhje me Statutin. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Palët kontraktuese janë të detyruara të bashkëpunojnë me Komisionin, dhe të njëjtit t'u mundësojnë kryerjen efektive të detyrave në përputhje me Statutin.) – Propozim i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
2. Me kërkesë të Komisionit, organet kompetente të pushtetit të palës kontraktuese, me kohë do të sigurojnë qasje në të dhëna dhe në dokumente, duke përfshirë edhe marrjen e deklaratave nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe zbatimin e hulumtimeve në terren, përpos nëse me të nuk do të shkelen rregullativat e palës kontraktuese për konfidencialitetin e të dhënave.
3. Të dhënat ose dokumentet, që tregojnë për kryerje të krimeve të luftës apo për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, dhe/apo në kryerësit e mundshëm, si dhe dokumentet të cilat janë hartuar me qëllim të fshehjes së krimeve të kryera apo të shkeljeve të të drejtave të njeriut, që nuk vlerësohen konfidenciale.
4. Në rastin kur shteti konsideron që zbulimi i të dhënave të caktuara ose dokumenteve të cilat i ka kërkuar Komisioni, do të ishte në kundërshtim me rregullativat për konfidencialitet, do të ndërmerr të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të tejkalimit të situatës kontestuese, me angazhim të përbashkët të Komisionit dhe Shtetit. Këto masa nënkuptojnë, por nuk kufizohen vetëm në:
  - (a) Deklarimin e Komisionit lidhur me relevancën e të dhënave dhe dokumenteve të cilat i kërkon; dhe
  - (b) Marrëveshjen për kushtet e zbulimit të të dhënave, duke përfshirë, ndër të tjera, zbulimin e pjesshëm të përmbajtjes së dokumenteve, kufizimin në publikimin e të dhënave si dhe aplikimin e masave tjera mbrojtëse për konfidencialitetin e të dhënave.

## Neni 12

### *Bashkëpunimi i Komisionit me shtetet tjera dhe me organizatat ndërkombëtare*

Komisioni mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me shtetet jashtë territorit të RSFJ-së së dikurshme dhe me organizatat ndërkombëtare.

## PJESA IV – QËLLIMET DHE DETYRAT E KOMISIONIT

### Neni 13

#### *Qëllimet*

Komisioni ka këto qëllime:

- 12
- a) Të vërtetoj faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1991 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001 në ish RSFJ-së; - qëndrimi i kryetarëve të Serbisë, Kroacisë, Malit të Zi, kryetares së Kosovës, anëtarit kroat të Presidencës në mandatin e kaluar dhe anëtarit boshnjak të Presidencës në mandatin e kaluar dhe të ri (të vërtetojë fakte për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme, në periudhën nga 1 Janari i vitit 1991 deri më 31 Dhjetor të viti 2001, rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat të cilat janë rrjedhojë e këtyre krimeve dhe shkeljeve të të drejtave); - Propozim i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
  - b) të pranojë padrejtësitë që u janë shkaktuar viktimave, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe bashkëndjenjës për viktimat;
  - c) të kontribuojë në realizimin e të drejtës së viktimave;
  - d) të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në palët kontraktuese të pranojnë faktet për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut;
  - e) të kontribuojë në ndriçimin e fatit të të pagjeturve;

- f) të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së krimeve dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.
- (g) t'i kontribuojë përparimit të programeve arsimore në pajtim me faktet mbi krimet e luftës, shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut dhe viktimat, të cilat i konstaton Komisioni. – nen i ri, të dërguarit për KOMRA.

#### Neni 14.

##### *Detyrat*

Komisioni ka këto detyra:

- a. të grumbulloj të dhëna për rastet e krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të ofrojë përshkrim të detajuar për to, dhe të pasqyrojë mostrat e shkeljeve të të drejtave dhe pasojat e tyre;
- b. të grumbulloj të dhëna për fatin e të pagjeturve dhe të bashkëpunojë me trupat kompetente, të cilat, në palët kontraktuese, merren me hulumtimin për të pagjeturit;
- c. Të bëjë inventarizimin e humbjeve në njerëz në lidhje me luftën ose formën tjetër të konfliktit të armatosur:
- Civilët, të cilët kanë humbur jetën ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur; dhe
  - luftëtarët të cilët kanë humbur jetën, ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me format e tjera të konfliktit të armatosur;
- d. të grumbulloj të dhëna mbi vendet e burgosjes, të ndërlidhura me luftën, ose me format e tjera të konfliktit të armatosur, të personave të cilët janë burgosur në mënyrë jologjore, u janë nënshtruar torturave dhe sjelljeve ç'njerëzore, dhe të hartoj një regjistrim gjithëpërfshirës, duke mbrojtur identitetin e tyre, në rastet kur është e nevojshme;

13

të hulumtoj rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat në mënyrë vendimtare kanë ndikuar në shpërthimin e luftërave ose formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut; - Propozim i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

të hulumtoj rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat në mënyrë vendimtare kanë ndikuar në shpërthimin e luftërave ose formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut – qëndrimi i anëtarit boshnjak të Presidencës së B e H në mandatin e kaluar dhe të tashëm.

- e. të mbaj dëgjime publike, të viktimave dhe personave të tjerë, për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut;
- f. të rekomandoj masat, të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe me reparacionin për viktimat; dhe
- g. të hartoj, të publikoj dhe të prezantoj raportin përfundimtar, në mënyrën që ai të mund të depërtojë deri tek një numër sa më i madh i njerëzve në shtetet e territorit të RSFJ-së së dikurshme.

## PJESA V – KOMPETENCA E KOMISIONIT

### Neni 15

14

#### *Periudha dhe territori i hulumtimit*

##### Komisioni

i vërteton faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1991 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001 në territorin e ish RSFJ-së; - qëndrimi i kryetarëve të Serbisë, Kroacisë, Malit të Zi, presidentes së Kosovës, dhe anëtarit kroat të Presidencës së B e H në mandatin e kaluar;

i vërteton faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1991 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001 në territorin e ish RSFJ-së dhe i hulumton rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat në mënyrë vendimtare i kanë kontribuar shpërthimit të luftërave dhe formave të tjera të konflikteve të armatosura; - qëndrimi i anëtarit boshnjak të Presidencës së B e H në mandatin e ri;

(Komisioni vërteton faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në periudhën nga data 1 Janar 1991 deri me 31 dhjetor 2001, në territorin e ish RSFJ-së, dhe hulumton rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat vendosmërisht kanë kontribuar në shpërthimin e luftërave ose formave të tjera të konflikteve të armatosura, si

dhe të kryerjes së krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut, si dhe pasojat e krimeve dhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut, të cilat janë shfaqur në periudhën pas vitit 2001.) – propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë

### *Neni 16*

#### *Shkeljet e të drejtave në kompetencën e Komisionit*

Komisioni vërteton faktet lidhur me shkeljet e rënda të të drejtave ndërkombëtare humanitare dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të cekura në Nenin 1, të Statutit, me ç'rast këto krime dhe shkelje përfshijnë, por nuk kufizohen në: gjenocid, përndjekje, vrasje, robërim, burgosje kundërligjore, torturim, zhdukje të detyruar, dëbim dhe zhvendosje të detyruar të popullatës, përdhunime dhe forma të tjera të abuzimit seksual, konfiskim dhe shkatërrim të pronës në përmasa të mëdha, marrja e pengjeve, shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturoro-historike, shfrytëzimi i civilëve dhe robërve të luftës si “mbrojtje e gjallë”, dhe diskriminimi sistematik.

## **PJESA VI – AUTORIZIMET E KOMISIONIT**

15

### *Neni 17*

#### *Marrja e deklaratave*

1. Komisioni merr deklaratat për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut, sipas kompetencës së vet, nga viktimat, dëshmitarët, përfaqësuesit e institucioneve, dhe kryerësit e veprave.

(Komisioni bënë përpjekje të siguroj dhënien vullnetare të deklaratës, duke ruajtur kompetencën e saj sipas paragrafit 8, të këtij neni.) – propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

(Viktimat i japin deklaratat për vuajtjet e tyre dhe të afërmve të tyre, ekskluzivisht në bazë vullnetare.) – propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

2. Në rast se personi e refuzon dhënien e deklaratës për Komisionin, duke u thirrur në detyrimin ligjor për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, zbatohen dispozitat e Nenit 11, paragrafit 3 dhe 4 të këtij Statuti.

Dëshmitarët e kanë të drejtën e mosdhënies së përgjegjes në disa pyetje të veçanta dhe lirimin nga detyra e të dëshmuarit në pajtim me ligjet mbi procedurat penale të palëve kontraktuese. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Dispozitat e ligjit për procedurën penale në palën kontraktuese zbatohen në të drejtën e refuzimit të dhënies së përgjigjes në çështjet e caktuara dhe lirimit nga detyrimi për të dëshmuar, si dhe çështje të tjera lidhur me marrjen në pyetje të personave, të cilat nuk janë të rregulluara me Statutin e Komisionit.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

3. Në bazë të kërkesës së dhënësit të deklaratës, Komisioni mund të mundësoj edhe dhënien e deklaratës me mbrojtje të identitetit.

(Komisioni thërret personat nga paragrafi 1, në mënyrë të paraparë me rregullat për thirrjen e dëshmitarëve, sipas ligjit për procedurën penale të palëve kontraktuese. Komisioni mund të lidhë marrëveshje të veçanta me palët kontraktuese për mënyrën e thirrjes.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

(Nëse e vlerëson të përshtatshme, Komisioni mund t'ia paraqesë kallëzimin penal prokurorisë, territorialisht kompetente për sigurimin e prezencës së personit, gjegjësisht për shqiptimin e dënimit personit i cili refuzon të japë deklaratë, në pajtim me ligjin për procedurën penale të shtetit në të cilin ai person e ka vendbanimin, apo vendqëndrimin.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

4. Para, gjatë dhe pas dhënies së deklaratës, Komisioni sipas nevojës, siguron përkrahjen psiko-sociale për viktimat dhe dëshmitarët.
5. Komisioni i merr deklaratat:
  - a. në vendbanimin apo në vendqëndrimin e dhënësit të deklaratës,
  - b. në zyrat e Komisionit,
  - c. në përfaqësitë diplomatike-konsullare të palëve kontraktuese, nëse deklarata merret në vendet e treta, dhe
  - d. në territorin e shteteve të treta, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të atyre shteteve në rastet kur viktimat, dëshmitarët dhe personat tjerë nuk mund të japin deklarata në konsullatat dhe ambasadat e palëve kontraktuese.



## Neni 18

### *Grumbullimi i dokumentacioneve*

1. Komisioni mbledh dokumentacionin relevant dhe materiale të tjera, duke përfshirë:
  - a. dokumentacionin e qeverive, kuvendeve, presidencave, nga vetëqeverisjet lokale dhe territoriale, ndërmarrjeve publike dhe private, ushtrisë, policisë, shërbimeve informative;
  - b. aktgjykimet gjyqësore, transkriptet, shkresat gjyqësore dhe të prokurorive të Gjykatës Penale ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, të gjykatave dhe të prokurorive të internacionalizuara nga palët kontraktuese si dhe gjykatat e tjera, të cilat kanë zhvilluar procedura për krimet e luftës të kryera në territorin e ish Jugosllavisë. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA (aktgjykimet gjyqësore, transkriptet, shkresat gjyqësore dhe të prokurorive, shkresat e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavinë, gjykatave dhe prokurorive nacionale te palët kontraktuese, dhe gjykatave të tjera, të cilat kanë zhvilluar procedura për krime lufte të kryera në territorin e Jugosllavisë së dikurshme;) – propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
  - c. lëndët arkivore të prejardhjeve tjera;
  - d. tekstet gazetareske, xhirimet televizive dhe në radio;
  - e. mendimet e shkruara të ekspertëve dhe të përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave, të përgatitura me kërkesë të Komisionit ose me vetiniciativë të vetë autorëve.
2. Organet shtetërore, personat e tjerë juridik dhe qytetarët e palëve kontraktuese, janë të detyruar që me kërkesë të Komisionit me kohë t'i dorëzojnë në shikim të gjitha dokumentet dhe materialet tjera, të cilat do të mund të ishin të rëndësishme për realizimin e caqeve të saj.
3. Me rastin e dërgimit të kërkesës për dorëzimin e dokumentacionit apo të materialeve tjera, Komisioni bën përpjekje që në mënyrë sa më të saktë të përcaktoj llojin e të dhënave, të cilat do të duhej t'i përmbaj materiali i kërkuar.
4. Në rast se personi ose organi shtetëror refuzon t'ia dërgoj dokumentacionin Komisionit në shikim, duke u thirrur në detyrën ligjore për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, zbatohet dispozita e Nenit 11, paragrafët 3 dhe 4, të këtij Statuti.

## Neni 19

### *Hulumtimet në terren dhe vizitat*

Komisioni vërteton faktet relevante duke shkuar në teren, duke vizituar lokalitetet e krimit, vendet e robërimit, varrezat masive dhe të gjitha lokalitetet e tjera me interes për vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut me pajtimin e palëve kontraktuese. - ndryshim, të dërguarit për KOMRA.

Komisioni mund të lidhë memorandume mirëkuptimi, me organet shtetërore kompetente, për vizitat e tij në lokacionet e lartpërmendura. - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë

Komisioni mund të vizitojnë vendet e krimeve dhe varrezat masive, në mënyrë që të shprehë respekt për viktimat. - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë

## Neni 20

### *Dëgjimi publik i viktimave dhe personave të tjerë*

1. Komisioni mban dëgjime publike në të cilat viktimat flasin për vuajtjet e tyre dhe të afërmeve të tyre.
2. Dëgjimet publike përfshijnë edhe kryerësit e veprave, të cilët kanë karakter të krimit të luftës ose të shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, dëshmitarët si dhe personat që iu kanë ndihmuar viktimave.
3. Dhënia e deklaratave në dëgjimin publik është vullnetare.
4. Para, gjatë dhe pas dëgjimeve publike, Komisioni mund të aplikoj masa për mbrojtjen e identitetit, si dhe masa të veçanta për mbrojtje të integritetit psiko-fizik, si dhe masat e përkrahjes psiko-sociale.
5. Mediet elektronike në pronësi shtetërore, gjegjësisht shërbimet publike, në territoret e palëve kontraktuese, emitojnë direkt apo më vonë, dëgjimet publike. Mënyra e transmetimeve bëhet sipas marrëveshjes mes Komisionit dhe transmetuesve publik. Mediet elektronike komerciale kanë të drejtë të emitojnë dëgjimet publike, në kushte të njëjta dhe sipas rregullave, të cilat vlejné dhe për mediet në pronësi shtetërore, përkatësisht serviset publike.
6. Dëgjimet publike mund të mbahen në lokalitete të ndryshme.

## Neni 21.

### *Mbajtja e sesioneve tematike*

1. Komisioni mund të mbajë sesione publike për veprimtarinë e institucioneve shtetërore, organizatave politike, institucioneve kulturore dhe shkencore, kishave dhe bashkësive fetare, dhe medie, para ose gjatë luftës, gjegjësisht formave të tjera të konfliktit të armatosur, dhe që kanë të bëjnë me kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut.
2. Nëse personi, i cili është ftuar në mënyrë të rregullt nuk i përgjigjet ftesës së Komisionit ose refuzon për të dhënë deklaratë, Komisioni e lajmëron lidhur me këtë publikun dhe në raport e konstaton refuzimin e pjesëmarrjes në sesionin tematik. - ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Pjesëmarrja në sesionet tematike është e obligueshme. Nëse personi, i cili është ftuar në mënyrë të rregullt, pa shkak të arsyeshëm, nuk i përgjigjet thirrjes së Komisionit për pjesëmarrje në sesionin tematik, ose vjen por refuzon të japë deklaratë, aplikohet Neni 17, paragrafi 8, i Statutit.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
3. Mediet elektronike në pronësi shtetërore, gjegjësisht shërbimet publike, në hapësirat e palëve kontraktuese, transmetojnë direkt apo në termine të tjera, sesionet tematike të Komisionit. Mënyra e transmetimit të sesioneve tematike, rregullohet në bazë të marrëveshjes në mes të Komisionit dhe shteteve kontraktuese. Mediet elektronike komerciale kanë të drejtë të transmetojnë sesionet tematike, nën kushte të njëjta dhe sipas rregullave që vlejnë për media në pronësi shtetërore, gjegjësisht serviset publike.
4. Sesionet tematike nuk mund të mbahen në lokalitete të ndryshme.

19

## Neni 22

### *Rregulloret e Komisionit*

Komisioni nxjerr rregulloret e veçanta gjatë fazës përgatitore dhe gjatë veprimit - (ndryshim, të dërguarit për KOMRA) me të cilat rregullohet (metodologjia, - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë (veprimi ndryshim, të dërguarit për KOMRA) unike për:

- marrjen e deklaratave;
- grumbullimin e dokumentacionit;
- rregullimin e procedurave për dëgjime publike;
- rregullimin e sesioneve tematike;
- hartimin e listës së humbjeve në njerëz;

- sigurimin e ndihmës psiko-sociale dhe mbështetjen për viktimat; dhe
- çështjet e tjera të rëndësishme për punën e Komisionit.

## PJESA VII – ZGJEDHJA E ANËTARËVE DHE ANËTAREVE TË KOMISIONIT

### Neni 23

#### *Përbërja e Komisionit*

Komisionin e përbëjnë 20 anëtarë dhe anëtare, me ç' rast:

- në Bosnjë dhe Hercegovinë zgjidhen 5 anëtarë/anëtare;
- në Kroaci, Kosovë, dhe Serbi zgjidhen nga 3 anëtarë/anëtare,
- në Mal të Zi, Maqedoni dhe Slloveni, zgjidhen nga 2 anëtarë/anëtare.

### Neni 24

#### *Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit*

- Anëtari/anëtarja e Komisionit është:
  - Shtetas/shtetase e palës kontraktuese;
  - Person me kualitete të larta morale, me integritet dhe autoritet, i përkushtuar në dialogun tolerant dhe konstruktiv për zgjidhjen e kontesteve, i cili mund të gëzojë besimin e të gjitha palëve kontraktuese;
  - Person i cili ka njohuri profesionale që në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i kontribuojë realizimit të detyrave të Komisionit. – paragraf i ri, të dërguarit për KOMRA.
  - Person me aftësi psiko-fizike për kryerjen efikase dhe në kontinuitet të detyrave të anëtarit/anëtares së Komisionit.

(Në palën kontraktuese zgjidhet së paku një femër, gjegjësisht së paku një mashkull, për anëtar/e të Komisionit.) **propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.**

(Në palën kontraktuese, me rastin e zgjedhjeve të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, duhet përkushtim që të sigurohet edhe përfaqësim etnik në Komision,

në atë mënyrë që, krahas pjesëtarit/pjesëtares nga radhët e bashkësisë më të madhe në numër, do të mundohet të zgjedhë edhe njërin/njëren ose më shumë pjesëtarë/pjesëtare nga bashkësia tjetër etnike, gjegjësisht nga bashkësitë e tjera etnike në atë palë kontraktuese;) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

2. Anëtar/anëtare e Komisionit nuk mund të jetë personi:
  - a. që ka ushtruar funksion të shquar politik; në dy vitet e fundit, para shpalljes së konkursit për zgjedhje të anëtarëve/anëtareve të Komisionit, ose në periudhën kohore e cila është përfshirë në kompetencën e Komisionit; - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
  - b. Për të cilin/cilën ekziston dyshimi serioz se është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, ose ka mbështetur, ndihmuar ose nxitur kryerjen e veprave të tilla, ose ka kontribuar në mos dënimin e atyre veprave, ose është në lidhje të ngushta me personin e gjykuar, akuzuar, ose që është nën hetime për vepra të tilla.

#### **Neni 25**

##### ***Njëjtësimi i procedurës në përzgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit***

Në secilën palë kontraktuese, zgjidhen anëtarët/anëtares të Komisionit, sipas procedurës së njëjtë, të paraparë me këtë Statut.

21

#### **Neni 26**

##### ***Kandidimi i anëtarëve dhe anëtareve***

1. Shoqatat e qytetarëve, institucionet arsimore, institucionet shkencore, ose 30 qytetarë të palës kontraktuese mund të propozojnë kandidat/kandidate për anëtarë/anëtare të Komisionit, i cili/a zgjidhet në atë palë kontraktuese, me pëlqimin e kandidatit/kandidates. - ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Shoqatat e qytetarëve, institucionet arsimore, institucionet shkencore, bashkësitë fetare, sindikatat ose 30 qytetarë të palës kontraktuese mund të propozojnë kandidat/kandidate për anëtarë/anëtare të Komisionit, i cili/a zgjidhet në atë palë kontraktuese, me pëlqimin e kandidatit/kandidates.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
2. Procedurat e kandidimit dhe seleksionimit primar të kandidatit/kandidates në palën kontraktuese i zbaton Këshilli seleksionues.

## Neni 27

### *Përbërja dhe zgjedhja e Këshillave seleksionuese*

1. Këshillin seleksionues në secilin shtet e përbëjnë shtatë anëtarë/anëtare, që duhet t'i plotësojnë kriteret, të cilat vlejné për përzgjedhjen e anëtarëve/anëtareve të Komisionit, përveç ndalesës për kryerjen e funksioneve të theksuara politike. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Këshillin seleksionues në secilin shtet e përbëjnë 9 anëtarë/anëtare, të cilët duhet t'i plotësojnë kriteret, të cilat vlejné për përzgjedhjen e anëtarëve/anëtareve të Komisionit, përveç ndalesës për kryerjen e funksioneve të theksuara politike në periudhën në dy vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, dhe në periudhën, e cila përfshihet në kompetencën e Komisionit.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë
2. Anëtarët/anëtares e Këshillit seleksionues nuk mund të kandidohen për anëtarësim në Komision.
3. Katër anëtarë të Këshillit seleksionues i emëron kryetari/presidenca dhe atë tre në bazë të propozimit të organeve ligjvënëse, të gjykatës supreme ose kushtetuese dhe ministrisë së drejtësisë, kurse të katërtin e emëron personalisht. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Tre anëtarët/anëtares e Këshillit seleksionues i emëron ministri kompetent për të drejtat e njeriut, me pëlqim të Komisionit parlamentar ose të Komisionit kompetent për të drejtat e njeriut ose marrëdhëniet ndërnacionale.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
4. Tre anëtarë/anëtare të Këshillit seleksionues përzgjidhen nga anëtarët e Koalicionit për KOMRA në palën kontraktuese.

(Gjashtë anëtarët/anëtares e parë/a të Këshillit seleksionues emërohen, gjegjësisht zgjedhën në bazë të paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, në afatin prej 45 ditësh, nga dita e ratifikimit të fundit të Kontratës ndërkombëtare për themelimin e Komisionit.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

(Ministri kompetent shpall zgjedhjen e katër anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit seleksionues, dhe në afatin prej 8 ditësh shpall konkursin për zgjedhjen edhe të 3 anëtarëve/anëtareve të tjerë të komisionit.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

(Gjashtë anëtarët/anëtares e përzgjedhur më parë, do të përkushtohen që të zgjedhin tre anëtarët/anëtares e mbetur të Këshillit seleksionues, me konsensus,

dhe nëse një gjë e tillë nuk do të jetë e mundur, atëherë zgjedhja bëhet me shumicë të votave.) - i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

(Ministri kompetent, Koalicioni për KOMRA dhe anëtarët/anëtareset e Këshillit seleksionues, të emëruar dhe zgjedhur në bazë të paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, do të sigurojnë që së paku 1/3 e anëtarësisë të përbëhet nga femrat, gjegjësisht meshkujt, dhe do të përkushtohen që të sigurojnë që 1/3 e anëtarësisë të përbëhet nga përfaqësuesit/përfaqësueset e shoqatës së viktimave, duke përfshirë edhe shoqatat e viktimave, të cilat nuk janë anëtare të Koalicionit për KOMRA, me kusht që të jenë të regjistruara, së paku tre vjet para nënshkrimit të kontratës për themelimin e Komisionit.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

(Ministri kompetent shpall zgjedhjen e Këshillit seleksionues dhe i siguron kushtet për punën e tij.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

5. Kryetari/presidenca e shpall zgjedhjen e Këshillit seleksionues dhe i siguron kushtet për punën e tij. - paragraf i ri, të dërguarit për KOMRA.
6. Me Këshillin seleksionues kryeson anëtari/anëtarja më e vjetër, që cakton mbajtjen e seancës konstitutive në afat prej 45 ditësh nga data e shpalljes së zgjedhjes së Këshillit seleksionues - ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Me Këshillin seleksionues kryeson anëtari/anëtarja më i/e moshuar, i/e cili/a e cakton mbajtjen e seancës konstitutive në afatin prej 43 ditësh nga dita e shpalljes së konkursit sipas paragrafit 6 të këtij neni.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

23

## Neni 28

### *Zgjedhja e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim në Komision nga ana e Këshillit seleksionues*

1. Këshilli seleksionues, në secilin shtet, në afatin prej 8 ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes konstitutive, shpall konkurs për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, në afatin prej 30 ditësh.
2. Në afat prej tetë ditësh nga data e mbylljes së konkursit, Këshilli seleksionues shpall në faqen e internetit të kryetarit/presidencës: - ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Në afatin prej 8 ditësh, nga dita e mbylljes së konkursit, Këshilli seleksionues shpall në internet faqen e Ministrisë kompetente sipas Nenit 27, paragrafi 3, si vijon) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

- a. Numrin e përgjithshëm të kandidaturave të arritura;
- b. Listën e kandidatëve/kandidateve, që ka vendosur për ta thirrur për intervistë. Intervistat janë të hapura për publikun. - (ndryshim. Të dërguarit për KOMRA. (Këshilli seleksionues mund të vendosë që t'i intervistojë të gjithë ose disa prej kandidatëve/kandidateve. Intervista është e hapur për publik.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
3. Këshilli seleksionues mund të kërkojë informata mbi kandidatin/kandidaten nga organet shtetërore dhe institucionet publike. - ndryshim. Të dërguarit për KOMRA. (Këshilli seleksionues mund të kërkojë informata për kandidatin/kandidaten nga organet shtetërore dhe institucionet publike, ndërsa ato janë të obliguara që në kërkesë të Këshillit për qasje në informata të përgjigjen më urgjentisht) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
4. Këshilli seleksionues përkushtohet që të gjitha vendimet t'i marrë me vendim unanim, ndërsa, në rast kur konsensusi nuk mund të arrihet, do të vendoset me shumicë prej 5 anëtarëve/eve.
5. Këshilli seleksionues e vlerëson plotësimin e kushteve të kandidatëve/kandidateve, kandidaturat e të cilëve i ka marrë në shqyrtim dhe e ngushton përzgjedhjen në listën e cila përmban numrin për dy deri në tre herë më të madh të kandidatëve dhe kandidateve nga numri i anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, të cilët zgjedhën në palën kontraktuese.
6. Në afatin prej 40 ditësh, nga dita e mbylljes së konkursit Këshilli seleksionues shpall listën e kandidatëve/kandidateve, dhe të njëjtën ia dërgon, po të njëjtën ditë, kryetarit/kryesisë së palës kontraktuese.

## Neni 29

### *Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit nga ana e kryetarit/kryesisë së palëve kontraktuese*

1. Kryetari/kryesia e shtetit kontraktues kryejnë zgjedhjen përfundimtare të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, të cilët zgjedhin në palën kontraktuese në mesin e kandidatëve dhe kandidateve nga lista të cilën ia dërgon Këshilli seleksionues.
2. Kryetarët/kryesitë e palëve kontraktuese e informojnë njëri-tjetrin për zgjedhjet e tyre 30 ditë nga dita kur Këshilli seleksionues ua dërgon listën e kandidatëve, para se për këtë ta informojnë publikun.



3. Kryetarët/kryesitë e palëve kontraktuese i shpallin emrat e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit 15 ditë nga dita kur të gjithë pranojnë njoftimin nga paragrafi 2 të këtij neni.

### **Neni 30**

#### ***Mbledhja konstitutive***

1. Anëtari/anëtarja më e vjetër e Komisionit thërret mbledhjen konstitutive në selinë e Komisionit, në afatin prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjeve, dhe e kryeson Komisionin deri në zgjedhjen e anëtarit kryesues/anëtares kryesuese.
2. Në pjesën solemne, hyrëse, të mbledhjes konstitutive të Komisionit, marrin pjesë kryetari/anëtarët e kryesisë së palëve kontraktuese.
3. Në pjesën hyrëse të mbledhjes konstitutive anëtarët dhe anëtares e Komisionit nënshkruajnë një ekzemplar të Statutit, flasin dhe e nënshkruajnë këtë deklaratë: “Betohe në nderin tim që funksionin e anëtarit/anëtares të Komisionit do ta kryej në përputhje me Statutin, me përkushtim, me paanshmëri dhe i pavarur, duke u përpjekur që të arsyetoj besimin e dhënë dhe të kontribuoj në realizimin e qëllimeve të Komisionit”.

25

### **Neni 31**

#### ***Zgjedhja e kryesuesit/kryesueses dhe miratimi i Rregullores së punës***

1. Anëtarët dhe anëtares e Komisionit e zgjedhin anëtarin kryesues/anëtares kryesuese dhe miratojnë Rregulloren e punës së Komisionit në afat prej 60 ditësh nga dita e mbledhjes konstitutive.
2. Anëtarët dhe anëtares e Komisionit mund të vendosin që funksioni i kryesuesit/kryesueses të kufizohet në periudhë të caktuar kohore.

### **Neni 32**

#### ***Kuorumi dhe vendimmarrja***

1. Kuorumi për punë të Komisionit ekziston kur janë prezent së paku 15 anëtarë/anëtares të Komisionit. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Kuorumi për punë të Komisionit ekziston kur janë prezent së paku 14 anëtarë/anëtares të Komisionit.) – propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

por, kur konsensusi është i pamundur të arrihet, së paku 15 anëtarë/e duhet të pajtohen për marrjen e vendimit, me pajtimin e së paku njërit prej anëtarëve të secilit shtet përkatësisht populli konstituues në Bosnjë dhe Hercegovinë. ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Komisioni bën përpjekje që të gjitha vendimet e Komisionit t'i nxjerrë njëzëri, por, kur konsensusi është i pamundur të arrihet, së paku 14 anëtarë/e duhet të pajtohen për marrjen e vendimit.) propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

3. Komisioni mund të vendosë që për miratimin e vendimit procedural të jetë i mjaftueshëm pajtimi i shumicës së thjeshtë, i të gjithë anëtarëve dhe anëtareve.
4. Me Rregulloren e punës, Komisioni rregullon çështjet procedurale, duke përfshirë edhe rregullat për ndryshime dhe plotësime të Rregullores. – paragraf i ri, të dërguarit për KOMRA.

### Neni 33

#### *Ndërprerja e mandatit të anëtarit/anëtares*

1. Mandati anëtarit/anëtares të/së Komisionit pushon me kalimin e mandatit të Komisionit, si dhe në rastet:
  - a. Dhënies së dorëheqjes në formë të shkruar;
  - b. Vdekjes;
  - c. Vendimit të plotfuqishëm gjyqësor për kufizimin ose privimin nga aftësia afariste;
  - d. Vendimit të plotfuqishëm gjyqësor me dënim me burg të pakusht; dhe
  - e. Shkarkimi.
2. Në rastet e parapara në paragrafin 1, pika (a), (b), (c), dhe (d), të këtij neni, Komisioni e konstaton ndërprerjen e mandatit dhe për këtë e informon Kryetarin/Kryesinë e palës kontraktuese, i cili/e cila në afatin prej 15 ditësh do të zgjedhë anëtarin/anëtares e re të Komisionit nga lista të cilën e ka përcaktuar Këshilli seleksionues në procedurën e propozimit të kandidatëve për anëtarët dhe anëtares e Komisionit.
3. Anëtarin/anëtarja e Komisionit mund të shkarkohet nga detyra në rast të mosplotësimit të obligimeve nga neni 34 dhe 36. (si dhe në rast të dënimit me aktgjykim të plotfuqishëm për veprë penale, e cila e dëmton integritetin dhe kredibilitetin e anëtarit/anëtares të/së Komisionit, si dhe në rastin e pamundësisë

së vazhdueshme të kryerjes së punës zyrtare, për shkak të gjendjes së vështirë mendore, emocionale dhe fizike.) - **propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.**

(Komisioni përcakton propozimin për shkarkim të anëtarit/anëtares, me përjashtim të tij/saj, dhe propozimin ia dërgon kryetarit/kryesisë së palës kontraktuese në të cilin është zgjedhur për anëtar/anëtare të Komisionit, për të cilin propozohet shkarkimi. Para se të përcaktohet propozimi për shkarkim, Komisioni do t'i mundësoj anëtarit/anëtares, për shkarkimin e të cilit vendoset, që të njoftohet me provat, të ngritura kundër tij/saj, që t'i paraqesë provat në dobi të tij/saj.) - **propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.**

4. Në afatin prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të propozimit, Kryetari/Kryesia e shtetit vendosin për shkarkim dhe për rastin e shkarkimit, dhe zgjedh anëtarin/anëtaren e re të Komisionit nga lista, të cilën Këshilli seleksionues e ka përcaktuar në procedurën e propozimit të kandidatëve/kandidateve për anëtarësim në Komision.

#### **Neni 34 - **propozimi i Koalicionit për KOMRA, i fshirë.****

*Largimi i përkohshëm nga detyra e anëtarit/anëtares së Komisionit*

(Nëse kundër anëtarit/anëtares të/së Komisionit do të jetë iniciuar hetimi, për veprë penale, me të cilën cenohet kredibiliteti i tij/saj ose Komisioni kupton për rrethana të tjera në raport me anëtarin/anëtaren, e cila seriozisht e cenon ose mund ta cenojë integritetin dhe kredibilitetin e Komisionit, ose kur kryerja e detyrave të anëtarit/anëtares së Komisionit është vështirësuar për shkak të gjendjes së tij/saj mentale, emocionale, ose fizike, Komisioni mund të vendosë që përkohësisht ta largoj anëtarin/anëtaren me të cilin/me të cilën kanë të bëjnë shkaqe të tilla, përderisa nuk verifikohet bazueshmëria e tyre, gjegjësisht për derisa nuk ndërpriten.)

27

# PJESA VIII – TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE/ANËTAREVE DHE PERSONELIT TË KOMISIONIT

## Neni 34

### *Ndërgjegjshmëria, pavarësia dhe paanshmëria*

1. Anëtarët dhe anëtares, të punësuarit apo personat e angazhuar në ndonjë mënyrë tjetër në Komision, janë të obliguar që të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe akteve tjera të cilat i nxjerr Komisioni, me ndërgjegje, me paanshmëri dhe në pavarësi nga interesat e cilësdo partie politike, qeverie ose organeve të tjera të pushtetit, grupeve të interesit ose të cilit do personi.
2. Anëtarët dhe anëtares e Komisionit si dhe personat e tjerë të punësuar në Komision nuk mund të ushtrojnë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër i cili do të mund të rrezikonte kryerjen e detyrave të Komisionit ose të sjellë në dyshim pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Anëtari/anëtarja e Komisionit dhe të punësuarit e tjerë në Komision janë të obliguar që Komisionit t'ia paraqesin konfliktin ekzistues, ose të mundshëm të interesit.
3. Nëse Komisioni kupton që anëtari/anëtarja e Komisionit ose i punësuar/e punësuar në Komision kanë konflikt interesi, do të përjashtoj atë person nga veprimi i mëtejshëm për çështje e cila është e përfshirë me konflikt interesi, ose do të ndër marrë masa me qëllim të shkarkimit, gjegjësisht largimit të përkohshëm të anëtarit/anëtares gjegjësisht të largojë nga puna të punësuarin/punësuarën nga Komisioni.
4. Nëse Komisioni nuk do të jetë i informuar me kohë për rrethanën e cila rezymon në konflikt interesi për anëtarin/anëtaren e Komisionit ose person tjetër të punësuar në Komision, dhe ai person merr pjesë në vendimmarrje ose ndërmerr veprime për çështjet që nënkuptojnë konflikt interesi, Komisioni, me t'u njoftuar për një rrethanë të tillë, do të përsërisë shqyrtimin e asaj prove, përkatësisht do të nxjerrë vendimin, dhe nëse është e domosdoshme që të siguroj që vendosja lidhur me atë çështje të përsëritet, përkatësisht që veprimin ta zbatoj përsëri, pa pjesëmarrjen e atij personi.

## Neni 35

### Privilegjet dhe imuniteti

1. Me qëllim të ruajtjes së pavarësisë së Komisionit dhe veprimtarinë e saj të papenguar, anëtarët/anëtares e Komisionit dhe të punësuarit/punësuarat në Komision, gjatë kohës së kryerjes së funksioneve të veta gëzojnë privilegjet dhe imunitetet si vijon:
  - a. Imunitet nga paraburgosja dhe sekuestrimi i bagazhit personal;
  - b. Imuniteti nga të gjitha llojet e procedurave ligjore, në raport me mendimin e shprehur dhe veprimin, me mirëbesim, brenda kornizave të kryerjes së detyrave, dhe
  - c. Përfundimisht nga çfarëdo kufizimi të lirisë së lëvizjes në raport me kryerjen e punëve dhe detyrave të Komisionit dhe në lidhje me vajtje ardhjet në shtetin në të cilin kryejnë funksionin.
2. Imuniteti i paraparë në paragrafin 1 pika b. të këtij neni, në raport me shprehjen e mendimit mbetet në fuqi edhe pas pushimit të detyrës si anëtarë/anëtares e Komisionit, gjegjësisht me përfundimin e angazhimit në Komision.
3. Komisioni ka për obligim t'ia heqë imunitetin anëtarit/anëtares dhe të punësuarit/punësuarës, nëse vërtetohet se imuniteti do të sjellë pengesa në rrjedhat e drejtësisë dhe do të rrezikojë besimin e opinionit në punën e Komisionit.

29

## Neni 36

### Mbrojtja e burimeve dhe të dhënave të besueshme

1. Anëtarët dhe anëtares e Komisionit, të gjithë të punësuarit dhe personat e tjerë të angazhuar në ndonjë mënyrë tjetër nga ana e Komisionit, kanë për obligim të ruajnë fshehtësinë e të gjitha të dhënave për të cilat kanë mësuar gjatë kohës së kryerjes së detyrave në Komision. (duke përfshirë identitetin e personit, i cili ka dhënë informatat me kusht të konfidencialitetit për identitetin e tij, dhe që ato të mos i shfrytëzojnë për qëllime personale, për aq kohë sa Komisioni nuk vendos që ato të dhëna t'i publikoj në formë të njoftimit zyrtar. Ky obligim nuk ka të bëjë me faktet e njohura publikisht.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
2. Komisioni nuk është i autorizuar që prokurorisë t'ia jep të dhënat dhe të zbulojë identitetin e personit, i cili i ka dhënë të dhënat pa pëlqimin e atij personi. - paragraf i ri, të dërguarit për KOMRA.

### Neni 37

#### *Statusi i anëtarëve/anëtareve të Komisionit dhe i personelit të Komisionit*

1. Anëtarët dhe anëtares e Komisionit dhe të punësuarit e tjerë në Komision, kryejnë detyrat me orar të plotë të punës.
2. Pagat, rrogat dhe kompensimet për anëtarët/anëtares e Komisionit dhe personat e angazhuar nga Komisioni, rregullohen me rregullore të Komisionit dhe paraqesin pjesë përbërëse të buxhetit të Komisionit.

## **PJESA IX – STRUKTURA E KOMISIONIT**

### Neni 38

#### *Sekretariati Ekzekutiv dhe paralelet tematike*

1. Komisioni vendos zyrën qendrore në Sarajevë, me emërtimin Sekretariati Ekzekutiv, detyra e të cilit është që të ofrojë mbështetjen teknike dhe administrative, si dhe operative për anëtarët e Komisionit, dhe koordinon punët mes zyrave të ndryshme dhe departamenteve tematike, të cilat i krijojnë Komisioni.
2. Komisioni emëron dhe shkarkon Sekretarin ekzekutiv, si dhe shefat e departamenteve tematike.
3. Të punësuarit dhe personat e tjerë të angazhuar në punën e Sekretariatit ekzekutiv dhe në departamentet tematike të Komisionit, angazhohen pavarësisht nga shtetësia e tyre.
4. Me rastin e përzgjedhjes së të punësuarve dhe personave të tjerë në Sekretariatit ekzekutiv, departamentet tematike, ekipet, dhe organet e tjera, të cilat i themelon Komisioni, aplikohet dispozita nga Neni 24, paragrafi 4, i këtij Statuti.

### Neni 39

#### *Zyrat e Komisionit në palët kontraktuese*

1. Komisioni i themelon zyrat në palët kontraktuese dhe me propozim të Sekretarit Ekzekutiv i emëron dhe shkarkon personat në krye të tyre.

(Komisioni në Sarajevë, në konsulta me Sekretariatën Ekzekutiv në Sarajevë dhe në zyrën e shtetit kontraktues, mund të themelojë ekipet mobile hetuese dhe zyrat rajonale në vendet tjera në territorin e shtetit kontraktues, dhe t'i emërojë dhe shkarkojë shefat e ekipeve, gjegjësisht të zyrave rajonale.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

2. Me propozim të Sekretarit Ekzekutiv, Komisioni mund të themeloj ekipin hetues, i cili, me pajtimin e palëve kontraktuese, do të mbledh të dhëna mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut. – ndryshim (Në propozim të Sekretarit Ekzekutiv, Komisioni mund të themeloj edhe ekipin hetues mobil, me autorizimin që të grumbullojë të dhëna në cilindo shtet kontraktues.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
3. Të punësuarit dhe personat e tjerë të angazhuar me punë në Sekretariatën Ekzekutiv, paralelet dhe zyrat në palët kontraktuese dhe ekipet, angazhohen pa marr parasysh shtetësinë e tyre.

#### **Neni 40**

##### ***Arkivi***

1. Sekretari Ekzekutiv konstituon Njësinë për arkiv dhe bazën e të dhënave të Komisionit, si dhe definon metodologjinë e arkivimit dhe digjitalizimin e dokumentacionit të grumbulluar.
2. Pasi të definojë metodologjinë nga paragrafi 1, më së largu 6 muaj nga konstituimi, Njësia për arkiv dhe bazë të të dhënave shndërrohet në Arkiv dhe bazë të të dhënave të Komisionit, detyra e të cilit është të arkivojë dhe digjitalizojë dokumentacionin e grumbulluar.
3. Secila prej zyrave në shtet, është e detyruar që të themeloj njësinë për arkiv dhe bazën e të dhënave, me ngarkesë që të arkivoj dhe digjitalizoj dokumentacionin, të cilin e ka grumbulluar në territorin e saj. Këto njësi, më së largu, 6 muaj nga themelimi, shndërrohen në arkiv dhe bazë të të dhënave në nivel të zyrës.
4. Arkivi dhe baza e të dhënave e Komisionit në Sarajevë do të unifikohet me njësitë për arkiv dhe bazën e të dhënave të zyrave në shtetet kontraktuese, më së voni 3 muaj para se të pushoj puna e Komisionit.
5. Më së paku 15 ditë para përfundimit të punës së Komisionit dorëzohen kopjet e lëndës së unifikuar arkivore dhe bazës së të dhënave, arkivave shtetërore të palëve kontraktuese dhe/ose institucioneve, të cilat disponojnë kapacitete për ruajtjen e tyre.

6. Lënda arkivore dhe baza e të dhënave të Komisionit, pas pushimit të punës së Komisionit, janë të hapura për qasje të pakufizuar ndaj të gjitha institucioneve dhe personave të interesuar, përveç dokumentacionit, i cili i nënshtrohet obligimit për ruajtjen e sekretit të të dhënave.

## PJESA X – FINANÇIMI I KOMISIONIT

### Neni 41

#### *Financimi*

1. Komisioni financohet me donacione vendore dhe të huaja si dhe me mjetet e organizatave ndërkombëtare. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Komisioni financohet nga kontributet e palëve kontraktuese dhe donacionet.)

(Kontributet e anëtarëve paraqesin kontributin nga mjetet vjetore buxhetore të palëve kontraktuese, të cilat përcaktohen në procedurën e rregullt buxhetore përderisa zgjatë puna e Komisionit.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

32

(Kontributet e palëve kontraktuese përcaktohen në vlera nominale, të cilat janë në pajtim me përqindjen e shteteve anëtare, në vlerën e përgjithshme të caktuar, e cila është e domosdoshme për funksionimin e Komisionit.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

(Palët kontraktuese do të arrijnë marrëveshje për kontributet e nevojshme për punën e Komisionit.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

(Donacionet sigurohen nga burimet e ndryshme, si nga organizatat ndërkombëtare, po ashtu edhe nga personat juridik vendorë.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.

2. Donacionet përbëjnë „mjetet, me të cilat udhëhiqet direkt“ dhe ato shfrytëzohen në pajtim me marrëveshjet, të cilat i ka lidhur Komisioni me donatorët. (me organizatat ndërkombëtare dhe personat vendorë juridik.) - ndryshime, të dërguarit për KOMRA.

(Kontributeve për Komisionin në natyrë, duke përfshirë edhe kontributet e palëve kontraktuese, nuk mund të vlerësohen si pjesë e kontributit sipas Nenit 42, paragrafi 2.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë



## Neni 42

### *Raportimi financiar*

1. Sekretari Ekzekutiv përgatit raportet vjetore për ekzekutimin e buxhetit themelor, në përputhje me rregulloret financiare të Komisionit.
2. Sekretari Ekzekutiv përgatit raporte mbi shfrytëzimin e donacioneve, në përputhje me rregulloret financiare të Komisionit, dhe me kërkesa të financierëve.
3. Auditori (revizori) i pavarur kryen auditimin e pavarur vjetor mbi shfrytëzimin e mjeteve themelore buxhetore dhe donacioneve, të cilat janë pranuar nga palët kontraktuese ose nga donatorët e tjerë. Rezultatet definitive mbi auditimin, pas procesit përkatës, dhe krahas komenteve të Komisionit, Komisioni i vë në shikim të opinionit.
4. Raportet nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni iu nënshtrohen auditimit nga ana e auditorit të pavarur.

## **PJESA XI – RAPORTI PËRFUNDIMTAR I**

### **KOMISIONIT**

33

## Neni 43

### *Hartimi dhe publikimi i Raportit përfundimtar*

1. Tre muaj para përfundimit të mandatit të vet, Komisioni publikon raportin përfundimtar.
2. Komisioni ua dorëzon njëkohësisht raportin përfundimtar kryetarëve/kryesisë së palëve kontraktuese dhe e publikon në faqen e internetit të Komisionit, njëkohësisht e publikon në të gjitha gjuhët zyrtare të palëve kontraktuese, në gjuhën angleze, si dhe në formë audio incizimi.
3. Komisioni ka për obligim që njëkohësisht, apo pas dorëzimit të Raportit përfundimtar të bëjë publik dhe të hapur rezymenë e tij.

## Neni 44

### *Përmbajtja e Raportit përfundimtar*

1. Raporti përfundimtar përfshin hyrjen; faktet relevante për krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, dhe në pajtim me detyrat e komisionit të parapara sipas Nenit 14, të Statutit, regjistrin e humbjeve në njerëz, vendeve të burgosjes, personave të burgosur dhe të personave të cilët kanë përjetuar torturë dhe rekomandimet.

Raporti përfundimtar përfshin: hyrjen; faktet relevante për krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, siç është cekuar në nenin 1. Të Propozim Statutit për KOMRA, kuptimi i nocioneve në këtë Statut, dhe në pajtim me detyrat e komisionit të parapara sipas Nenit 14, të Statutit, regjistrin e humbjeve në njerëz, vendeve të burgosjes, personave të burgosur dhe të personave të cilët kanë përjetuar torturë dhe rekomandimet. Do të përshijë edhe "rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat në masë vendimtare kanë ndikuar në fillimin e luftërave ose formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjen e krimeve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut". –qëndrimi i anëtarit boshnjak të Presidencës së B e H në mandatin e mëparshëm.

2. Në mes tjerash, rekomandimet kanë të bëjnë me:
  - a. Hapat e mëtejme të palëve kontraktuese drejt përparimit të mirëbesimit në mes të shteteve dhe bashkësive në territorin e RSFJ-së së dikurshme;
  - b. Modelin përkatës të reparacioneve materiale dhe simbolike, me mënyrën dhe me reformën e institucioneve si dhe me mekanizmat, me të cilët sigurohet integrimi i fakteve të vërtetuara në programet arsimore nga palët kontraktuese – ndryshime, të dërguarit për KOMRA. (Modelin përkatës të reparacioneve materiale dhe simbolike, mënyrën për reformimin e institucioneve si dhe mekanizmat me të cilët sigurohet integrimi i fakteve të vërtetuara në sistemet e arsimit të palëve kontraktuese) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
  - c. Mënyrën e përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, përfshirë edhe propozimin për themelimin e mekanizmit të veçantë për realizimin e qëllimit të tillë.

*Gjetjet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut*

1. Komisioni ka autorizim që në bazë të fakteve të vërtetuara, në Raportin përfundimtar të konstatoj se ekzistojnë indicie serioze se personi i caktuar ka kryer krim lufte, gjegjësisht shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Gjetja e tillë nuk ka efekt të aktgjykimit gjyqësor, dhe as nuk e prejudikon rrjedhën e procedurës eventuale gjyqësore. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Komisioni ka autorizim që në bazë të fakteve të vërtetuara, në Raportin përfundimtar të konstatoj se ekziston dyshimi serioz se personi i caktuar ka kryer krim lufte, gjegjësisht shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Gjetja e tillë nuk ka efekt të aktgjykimit gjyqësor, dhe as nuk e prejudikon rrjedhën e procedurës eventuale gjyqësore.) – propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
  
2. Komisioni, në raportin përfundimtar, nuk i cek konstatimet kundër personit nëse nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme që atë ta njoftoj lidhur me këtë dhe që t'i jep mundësinë që të përgjigjet në pretendimet mbi përgjegjësinë për krimet e luftës përkatësisht mbi shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Në raportin përfundimtar, Komisioni nuk mund të nxjerrë gjetjet kundër ndonjë personi, nëse nuk ka ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm, që:
  - (a) Të njoftoj atë person lidhur me qëllimin e vet, për të nxjerrë gjetjet e tilla;
  - (b) T'i komunikoj atij personi përmbajtjen e gjetjes, të dhënat në bazë të të cilave nxirret gjetja, si dhe shkaqet në të cilat është bazuar gjetja e tillë,
  - (c) T'i ofroj personit mundësinë që brenda afatit të arsyeshëm të përgjigjet në gjetjen e propozuar; dhe
  - (d) Të verifikoj të gjeturat për personin e vdekur, të paktën nga tri burime.) – propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
  
3. Nga pikëpamja e rasteve të cilat janë proceduar në prezencë të të akuzuarit, para Gjykatave ndërkombëtare ose vendore, Komisioni mundet që në raportin përfundimtar të udhëzojë në aktgjykimin përkatës. Në këtë rast Komisioni mund të vërtetojë faktet e reja.

## Neni 46

### *Obligimi i Parlamentit dhe qeverisë që të shqyrtojnë Raportin përfundimtar*

1. Pas publikimit të Raportit përfundimtar, kryetari/kryesia e çdo pale kontraktuese, raportin ia dërgon kryetarit të parlamentit. (Në afatin prej një muaji – propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë). Pas pranimit të raportit, kryetari – ndryshim, të dërguarit për KOMRA) kryetari i parlamentit thërret seancë të veçantë të parlamentit, me qëllim të shqyrtimit të gjetjeve dhe rekomandimeve nga Raporti, ose e vë në rend të ditës këtë temë, për mbledhjen e radhës. Në seancë marrin pjesë një ose më shumë anëtarë të Komisionit.
2. Në afatin prej 6 muajsh pas publikimit të raportit përfundimtar të Komisionit, qeveria e çdo pale kontraktuese miraton dhe publikon në gazetën zyrtare të palës kontraktuese qëndrimin mbi zbatimin e rekomandimeve.
3. Në një afat të arsyeshëm, pas përgjigjes nga qeveria sipas paragrafit 2 të këtij neni, kryetari i parlamentit i çdo pale kontraktuese thërret seancën speciale të parlamentit me qëllim të shqyrtimit të përgjigjes së qeverisë dhe angazhimit të mundshëm të parlamentit me qëllim të zbatimit të rekomandimit të Komisionit.

36

## **PJESA XII – TË NDRYSHME** – propozimi i Koalicionit për KOMRA, i fshirë

### **Neni 48 – propozimi i Koalicionit për KOMRA, i fshirë**

#### *Veprat penale dhe sanksionet*

1. (Çdo person i cili:
  - (a) me vetëdije i jep Komisionit të dhëna të rreme, apo organit ose personit i cili vepron në emër të tij;
  - (b) që me kërcënim, forcë, me veprim ose premtim të përfitimeve shtyn personin tjetër për të dhënë të dhëna të rrejshme ose mosdhënien e të dhënave për Komisionin, apo organin apo personin, i cili vepron në emër të tij;
  - (c) asgjëson ndonjë dokument ose mjet me qëllim të pengimit të Komisionit që të zbatojë hulumtimin, ose

- (d) të zbardhë apo në ndonjë mënyrë tjetër zbulon të dhënë, të cilën e ka pranuar Komisioni me kusht konfidencialiteti, apo e tregon identitetin e personit, i cili ia ka dhënë informatën, me kusht konfidencialiteti, konsiderohet se ka kryer veprë penale të dënueshme me dënim me burg deri në një vit, ose me dënim në të holla ekuivalent me shumën prej 5.000 euro.
2. Sanksionet nga paragrafi 1 zbatohen edhe ndaj personave zyrtarë apo privatë, të cilët pa ndonjë arsye refuzojnë të veprojnë sipas kërkesës së Komisionit, gjegjësisht organit apo personit i cili vepron në emër të tij, për dorëzimin e dokumenteve për shqyrtim, apo të burimeve të tjera.
3. Në rast se personi refuzon t'i përgjigjet ftesës, ose refuzon dhënien e deklaratës para Komisionit, zbatohen dispozitat e Nenit 17, paragrafi 8 i këtij Statuti.)

**Neni 49 - propozimi i Koalicionit për KOMRA, i fshirë**

***Roli i Komisionit në procedimin penal***

(Komisioni ka autorizim që:

- (a) të rekomandoj, në rast se personi për të cilin Komisioni disponon me dyshime serioze se ka kryer krim lufte ose shkelje tjetër të rëndë të drejtave të njeriut, të ia komunikoj Komisionit të dhënat me rëndësi për zbulimin e lokalitetit dhe mbetjet mortore të personave të humbur, ose për zbulimin e kryerësve të tjerë të mundshëm dhe veprave të tjera, gjykatës para së cilës zhvillohet procedura penale, me kërkesë të akuzuarit ato t'i marrë si rrethanë lehtësuese me një rëndësi qenësore me rastin e përcaktimit të lartësisë së dënimit;
- (b) t'i propozoj kryerësit të gjykuar për veprë penale, falje të pjesërishtme, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, nëse ia komunikon Komisionit të dhënat e rëndësishme për zbulimin e lokalitetit me mbetjet mortore për persona të humbur, ose për zbulimin e kryerësve të tjerë të mundshëm; dhe veprave të tjera;
- (c) të propozoj zbutje të jashtëzakonshme të dënimit për kryerësit e veprës penale, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, nëse ia komunikon të dhënat e rëndësishme Komisionit për zbulimin e lokalitetit me mbetjet mortore të personave të humbur, ose për zbulimin e kryerësve të tjerë të mundshëm; dhe veprave të tjera.)

37

## PJESA XIII – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 47

#### *Përfundimi i punës së Komisionit*

1. Pas publikimit të raportit përfundimtar, Komisioni përfundon punën brenda afatit, më së gjati prej tre muajve.
2. Në atë periudhë kohore ndërmerren masat për sistematizimin, ndarjen dhe ruajtjen e arkivit, ndarjen e pronës, përmbushjen e obligimeve ndaj personave të tretë, shpërndarjen dhe prezantimin e raportit përfundimtar, si dhe hartimin e raporteve financiare dhe raportimin e punës së Komisionit.

### Neni 48

#### *Hyrja e Statutit në fuqi*

1. Originali i këtij Statuti, tekstet e të cilit janë në gjuhën shqipe, boshnjake, malazeze, kroate, maqedonase, sllovene, dhe serbe, vlerësohen njëllor autentike, dhe depozitohet te organi kompetent në Bosnjë e Hercegovinë, si vendi nikoqir.
2. Palët kontraktuese do të vendosin mbi mënyrat e pranimi përkatësisht të ratifikimit të këtij dokumenti, përkatësisht palët kontraktuese do të informoj mbi pranimin përkatësisht mbi ratifikimin e këtij dokumenti. – ndryshim, të dërguarit për KOMRA. (Shtetet kontraktuese do të njoftojnë shtetet e tjera lidhur me ratifikimin.) - propozimi i Koalicionit për KOMRA, e fshirë.
3. Statuti hyn në fuqi ditën e parë të muajit, pas kalimit të pesëmbëdhjetë ditëve nga data e pranimi përkatësisht (ndryshim, të dërguarit për KOMRA) e ratifikimit të fundit.

38

**Neni 49 – nen i ri, të dërguarit për KOMRA**

***Përgatitjet për themelimin e Komisionit***

Përgatitjet organizative dhe teknike për themelimin e këshillit seleksionues të Komisionit do t'i bëjnë shërbimet e duhura të kryetarëve, presidentes/Presidencës në bashkëpunim me Koalicionin për KOMRA.

